



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivery	20.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSICK	7042/2023		117



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1261/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi -Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, si dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1261/2023 të datës 06.10.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit numër 2284 të datës 22.09.2023 në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1261/2023 të datës 06.10.2023 të parashtruar nga ankuesi.
- II. Mbetet ne fuqi Njoftimi me numër protokollit 150/2023 i datës 19.07.2023 për kandidatin e suksesshëm i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës.
- III. Anullohet Vendimi 2284 i datës 22.09.2023 i Kryeinspektorit të Punës ne Inspektoratin e Punës, lidhur me anulimin e procedurës se rekrutimit me numër reference RN00011780 për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Divizionin e Koordinimeve në Inspektoratin e Punës në Rajonin e Gjilanit.
- IV. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, të ndërmer veprimet e nevojshme administrative që ankuesit ti lëshoj akt emërimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" ne Rajonin e Gjilanit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Inspektorati i Punës me datën 05.06.2023 ka shpallur konkursin me numër reference RN00011780 Lëvizje Brenda Kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit i cili konkurs ka qenë i hapur nga data 20.06.2023 deri me datën 27.06.2023. Sipas listës së datës 04.07.2023 të publikuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore ankuesi ka kaluar fazën e verifikimit paraprak.

Me datën 19.07.2023 Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës ka publikuar Njoftimin me numër protokoll 150/2023 përmes të cilit ankuesi është shpallur si kandidati i vetëm fitues me gjithsejtë 83.4 pikë, ndërsa përmes emailit të datës 20.07.2023 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, ankuesi është njoftuar se Komisioni i Vlerësimit për kandidatet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit, e ka vlerësuar me gjithsejtë 83.4 pikë të përgjithshme.

Ankuesi përmes emailit të datës 01.09.2023, i është drejtuar Njesisë se Burimeve Njerëzore, duke kërkuar informatë lidhur me konkursin në fjale pasi që i njëjti është kandidat i përzgjedhur dhe se nuk ka ende asnjë informacion tjetër lidhur me fillimin e punës. Ndërsa Menaxheri i Burimeve Njerëzore në të njëjtën datë i është përgjigjur se kanë marr njoftim nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës që për konkursin në fjale kanë pranuar ankesa dhe deri në zgjedhjen e tyre jemi të obliguar të presim.

Ankuesi përmes emailit të datës 02.10.2023 i është drejtuar znj anëtare e Komisionit Vlerësues në procedurën e rekrutimit të larët përmendur, përmes të cilës ka kërkuar përgjigje se kur do njoftohet për fillimin e punës pasi që ankesat e parashtruara në Këshillin e Pavarur janë vendosur dhe të gjitha janë hedhur poshtë nga kjo e fundit. Anëtarja e komisionit me datë 03.10.2023 i është përgjigjur ankuesit se Konkursi për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në rajonin Gjilanit është anuluar nga Kryeinspektori i Punës në Inspektoratin e Punës.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër 2284 të datës 22.09.2023 të nxjerr nga Kryeinspektori i Punës për anulimin e konkursit me numër Reference RN00011780 Lëvizje Brenda Kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Divizionin e Koordinimeve Rajonin e Gjilanit, me datë 06.10.2023 ka parashtruar ankese pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendim ankimore se vendimi në fjale ka shkelje të dispozitave të procedurës administrative vlerësim të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 16.10.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në inspektoratin e Punës ndërsa Këshilli më datë 18.10.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 06.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës; Vendimin me numër 2284 të datës 22.09.2023; Konkursin me numër të referencës RN00011780 të datës 05.06.2023 për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal* në Divizionin e Koordinimeve Rajonin e Gjilanit; Njoftimin e datës 04.07.2023; Njoftimin me numër 148/2023 të datës 12.07.2023; Njoftimin për kandidatin e përzgjedhur me numër 150/2023 të datës 19.07.2023; Njoftimin me numër 158/2023 të datës 31.07.2023; Emalin e datës 17.07.2023 të drejtuar [ ] Emalin e datës 20.07.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 01.09.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 01.09.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 03.10.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 02.10.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 01.10.2023 të drejtuar [ ] ; Emalin e datës 05.10.2023 të drejtuar [ ] ; Vendimin me numër A.Nr.1068/2023 të datës 21.09.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; Vendimin me numër A.Nr.1120/2023 të datës 22.09.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.10.2023; Përgjigjen në naksë të datës 18.10.2023; Vendimin me numër 1758 të datës 13.07.2023 për Themelimin e Komisionit të pranimit; Akt emërimit e anëtarit të komisionit [ ] Akt emërimit e Anëtares [ ] ; Akt emërimit e anëtarit [ ] ; Akt emërimit e anëtarit [ ] ; Akt emërimit e anëtares [ ] ; Akt emërimit e anëtarit [ ] ; Akt emërimit e anëtares [ ] ; Listën e aplikanteve; Pyetjet e Intervistës me gojë të kandidateve të mbajtur me datë 18.07.2023; Rënditja përfundimtare e kandidateve e datës 18.07.2023; Vendimin me numër 126/2023 të datës 04.07.2023; Aplikacionin e ankuesit të datës 20.06.2023 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Vërtetimin e punësimit të datës 12.06.2023; Vendimin e datës 12.07.2010; Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 165 të datës 04.05.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës Fakulteti Juridik me të cilën dëshmohet së ankuesi ka marr titullin Bachelor I Juridikut; Certifikatën e datës 16.10.2009; Certifikatën me numër 30/22; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.01.2022; Certifikatën e datës 26.03.10 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Referencën e datës 19.05.20205; Vërtetimin punësimit të datës 12.06.2023; Aplikacionin e kandidatit [ ] të datës 27.06.2023 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Vendimin me numër 125/2023; Çërrfaten e rezultateve në punë të datës 26.04.2023; Certifikatën e datës 13.03.2023; Certifikatën e datës 10.06.2022; Kontratën e punësimit të datës 13.08.2009; Vërtetimin e datës 15.11.2010; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 23.12.2022; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punës të datës 24.12.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 24.09.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 01.06.2021; Dokumentin e identifikimit; Diplomën me numër 1795 të datës 20.06.2008; Akt emërimit e datës 30.07.2021; Aplikacionin e kandidatit [ ] të datës 26.06.2023 së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur; Akt emërimit e datës 01.11.2022; Vendimin me numër 128/2023 të datës 04.07.2023; Diplomën me numër 447 të datës 23.02.2000; Certifikatën e datës 09.12.1999; Dëshminë e datës 14.06.2002 lidhur me përvojën e punës; Kontratën e marrëdhënies së punës të datës 31.12.2008; Vërtetimin e datës 26.05.2003; Kontratën e punës të datës 01.01.2002; Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 18.04.20204; Dokumentin e identifikimit ; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 26.01.2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 02.12.2021; Certifikatën e datës 08.12.2010; Certifikatën e datës 10.12.2010; Certifikatën e datës 30.11.20010; Certifikatën e datës 21.09.2012; Mirënjohjen (pa date dhe

numër); Vërtetimin lidhur me përfundimin e kursit të kompjuterëve; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit të avancuar në menaxhim dhe Komunikim; Parashtrësën e datës 24.07.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër 2284 të datës 22.09.2023 i nxjerr nga Kryeinspektori i Punës për anulimin e konkursit me numër të referencës RN00011780 Lëvizje Brenda Kategorisë, për pozitën e punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Gjilanit ka shkelje të dispozitave të procedurës administrative vlerësim të gabuar të gjendjes faktike si dhe aplikim të gabuar të drejtës materiale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Konkursin me Nr. RN00011780, të datës 05.06.2023 Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën e punës " Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal" në Inspektoratin e Punës në rajonin e Gjilanit, si kriteret të përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve, në drejtimin, Juridik, Ekonomik dhe Teknik.*
- *Kualifikime të posaçme formale: Nuk ka.*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale.*

Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili pretendon se Kryeinspektori i Punës në Inspektoratin Punës ka vepruar kundërligjshëm me rastin e anulimit të konkursit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal në Gjilan, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se Inspektorati i Punës më datë 05.06.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Referencës: RN00011780 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin Rajonale në Gjilan dhe mbi bazë të përfundimit të afatit të aplikimit përgatitjes së listës së verifikimit paraprak, Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore bazuar në nenin 46 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil më datë 13.07.2023 ka propozuar themelimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë me nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita që rekrutohet dhe anëtarë të tjerë duke përfshirë edhe zëvendësuesit e tyre. Bazuar në Vendimin me Nr. Port: 1758 të datës 13.07.2023 është formuar Komisioni për Lëvizje Brenda Kategorisë më pozita përkatëse siç parashihet me dispozitat e cekura si më lartë dhe ky vendim është nxjerr nga Kryeinspektori i Punës i Inspektoratit të Punës.

Më datë 24.07.2023 inspektore e punës në Divizionin për Koordinimin Rajonale në Gjilan në cilësinë e palës së interesit/ndërhyrësit në procedure e cila nuk ka qene kandidate në konkursin në fjale ka parashtruar parashtrëse për ndërhyrje në këtë procedurë tek Inspektorati i Punës duke theksuar se Komisioni për Lëvizje Brenda Kategorisë është themeluar në kundërshtim me nenin 46 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil respektivisht duke theksuar se në komision është dashur të jenë dy Koordinator e jo dy Inspektor të Punës, ndërsa e njëjta më datë 28.08.2023 ka

parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes Vendimit A.nr.1120/2023 të datës 22.09.2023 e ka hedhë poshtë ankesën e datës 28.08.2023 të ankueses duke konstatuar se kjo ankuese nuk ka qenë kandidate në këtë procedurë për shkak që ka qenë nëpunëse e një kategorie më të ulët po ashtu e njëjta meqë nuk ka qenë pjesë e procedurës nuk ka pas të drejtë të kontestoj një procedurë të tillë ngase nuk i është cenuar asnjë e drejtë nga marrëdhënia e punës.

Rrjedhimisht meqenëse anulimi i konkursit është bere me arsyetimin se përbërja e Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë për pozitën e lartcekur, ka qene ne kundërshtim me dispozitat ligjore te Ligjit për zyrtarë publik dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht vendimi për anulimin e konkursit është bazuar ne Opinion Ligjor te Departamentit për planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore ne Inspektoratin e Punës lidhur me formimin e Komisionit Vlerësues për këtë procedure te rekrutimit atëherë Kolegji i Këshillit pasi ka analizuar Vendimin me Nr. Port: 1758 të datës 13.07.2023 për formimin e këtij komisioni, konstaton se sipas nenit 46 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil, është përcaktuar se: *"2.KVLBK përbëhet nga: 2.1. dy (2) anëtar nëpunës civil të specializuar në fushën përkatëse për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. dy (2) anëtar, nëpunës civil të nivelit me të lartë se pozita e lirë qe rekrutohet për lëvizjen brenda kategorisë të institucionit përkatës ose institucionit tjetër të shërbimit civil, njëri nga ta mbikëqyrës i Drejtpërdrejtë; 2.3. një (1) përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit"*, kështu që marr parasysh këtë dispozitë dhe akt emërimet e anëtareve të Komisionit, Kolegji konstaton se kryesuesi i Komisionit mbanë pozitën e punës Zëvendës Kryeinspektor i Punës për Siguri ne Pune dhe anëtari mbanë pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Ceshtje Ligjore gjegjësisht ne vlerësimin e kolegjit te dy këta anëtarë plotësojnë kriterin nëpunës civil të nivelit me të lartë se pozita e lirë qe është rekrutuar, ndërsa dhe mbajnë pozitën e punës Inspektorë të Punës si dhe mbanë pozitën e punës Zyrtare e Larte për Personel të gjithë këta janë kategori profesionale, duke përmbushur kështu kriterin nga Njësia e Burimeve Njerëzore dhe kriterin e specializimit në fushat përkatëse për të cilin zhvillohet konkurrimi, andaj nisur nga ky konstatim Kolegji i Këshillit vlerëson se përbërja e Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë i themeluar sipas Vendimit me Nr. Port: 1758 të datës 13.07.2023 ka qene ne pajtim me dispozitat e nenit 46 të të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin në Karrierë të Shërbimit Civil. Po ashtu lidhur me formimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë e që ne përbërje kishte anëtar me pozitën të Inspektorit të Punës dhe që nuk eshte në kundërshtim me dispozitat e lartcekura është vendosur sipas Vendimit A.nr.766/2023 të datës 30.06.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që pretendimi i ankuesit lidhur me këtë çështje është i bazuar.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore në fuqi referuar procedurës dhe kushteve që duhet ti duhet ti plotësojnë nëpunësit civilë për lëvizjen brenda kategorisë, përkatësisht:

- Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ku me nenin 38 përcaktohet: 1. *Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë.* 2. *Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e*

posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji. 3. Fillimi i procedurës së konkurrimit shpallet në afat jo më të shkurtër se 15 ditë nga data e caktuar për paraqitjen e aplikimit, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me nijete të tjera të përshtatshme. 4. Procedura e përzgjedhjes është një procedurë konkurruese dhe organizohet nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit ku është pozita e lirë. 5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të kësaj çështje si dhe aktin administrativ të kundërshtuar me ankesë përkatësisht Vendimin me numer Nr.2284/23 të datës 22.09.2023, të Kryeinspektorit të Punës në Inspektoratin e Punës për anulimin e Konkursit me numër të referencës RN00011780, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal*, dhe si rrjedhojë konstatoi se i njëjti është nxjerrë nga personi jo kompetent dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat materiale. Rrjedhimisht, Kryeinspektori i Punës i Inspektoratit të Punës nuk ka tagër ligjor për vlerësimin e ligjshmërisë së procedurave të rekrutimit, përfshirë anulimin apo lënien në fuqi të konkurseve të shpallura, respektivisht në rastin konkret dhe bazuar në arsyetimin e anulimit të konkursit sipas Vendimit me numer Nr.2284/23 të datës 22.09.2023, të Kryeinspektorit të Punës në Inspektoratin e Punës, anulimi është bere për shkak te përbërjes se komisionit te vlerësimit , ndërsa pre këtë çështje gjegjësisht per përbërjen e anëtareve të komisionit te Vlerësimit për për lëvizje brenda kategorisë, ka vendosur Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit A.nr.766/2023 të datës 30.06.2023. Andaj, nisur nga këto fakte, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52 të Ligjit të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një akt administrativ i nxjerrë nga organi jo kompetent dhe me shkelje ligjore konsiderohet akt i paligjshëm dhe si i tillë nuk prodhon asnjë pasojë juridike.

Siç u përcaktua më lartë, rrjedhimisht duke qenë se Vendimi Nr.2284/23 të datës 22.09.2023, i Kryeinspektorit të Punës në Inspektoratin e Punës për anulimin e Konkursit me numër të referencës RN00011780, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Koordinim Rajonal*, është nxjerrë nga organi jokomptent dhe në kundërshtim më dispozitat materiale, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejta dhe të bazuara, kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që të anulohet Vendimi me numer NR.2284 i datës 22.09.2023 i nxjerr nga Kryeinspektori i Punës në Inspektoratin e Punës , duke lënë në fuqi renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 19.07.2023, si dhe duke obliguar Menaxherin e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës që konform listës përfundimtare të lëshoj aktin e emërimit për ankuesin respektivisht të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër: A.nr.1261/2023

Ilire MEHMETI -SHAQIRI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.